



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat Afatshkurtra të Industrisë TM2 2019



AGJENCIJA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

P a r a t h ö n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur për herë të tretë publikimin e rezultateve të Statistikave Afatshkurtra të Industrisë duke *paraqitur indeksin e vëllimit industrial* për periudhën TM2 – 2019 (2017=100).

Nga tremujori i parë i 2019, e këndej ky hulumtimi është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK-së dhe bazohet në deklarimet e ndërmarrjeve. Kjo anketë me të dhënat që ofron, synon të paraqet ecurinë në industri (*B - Nxjerrëse, C - Përpunuese, D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar dhe E - Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave*) në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit në industri.

Rezultatet e këtij hulumtimi në të njëjtën kohë përdoren për nevoja të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit në baza tremujore.

Komentet dhe sugjerimet e juaja janë të mirëseardhura!

Publikimi është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha	–	Drejtor i Departamentit
Ismajl Sahiti	–	Shef i divizionit
Hysni Elshani	–	Zyrtar i lartë
Dafina Kumnova	–	Zyrtare
Bekim Bojku	–	Zyrtar
Ahmet Cakolli	–	Zyrtar për dizajn

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën elektronike:

(E-mail: infoask@rks-gov.net)

Simbolet dhe shkurtësat

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

NVE - Nomenklatura e veprimtarive ekonomike

RSB - Regjistri Statistikorë i Bizneseve

SAN - Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve

TM1 - Tremujori i parë

TM2 - Tremujori i dytë

TM3 - Tremujori i tretë

TM4 - Tremujori i katërt

Simbolet

: - Mungojnë të dhënrat

n/a - Nuk aplikohet

Përmbytja

Faqe

1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	4
1.1. Objektivi dhe qëllimi.....	4
1.2. Fusha e mbulimit	4
1.3. Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) të të dhënave	4
1.4. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës	5
2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë	6
2.1. Definicione dhe përkufizime	6
2.2. Treguesit themelorë	6
3 Industria.....	7
3.1. Struktura e vëllimit të prodhimit nga aktivitetet Industriale (B,C, D dhe E)	7
3.2. Numri i të punësuarve nga aktivitetet Industriale (B, C, D dhe E).....	7
4 Indeksi i vëllimit të prodhimit dhe numrit të të punësuarve nga aktivitetet Industriale (B, C, D dhe E)8	
4.1. Indeksi i vëllimit të prodhimit	8
4.2. Indeksi i numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial.....	11

1. Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës

1.1. Objektivi dhe qëllimi

Objektivi kryesor i Anketës së Statistikave afatshkurtra të ndërmarrjeve industriale është paraqitja e trendëve nëpër periudha tremujore në sektorët (B, C, D dhe E) të Nomenklaturës së veprimtarive ekonomike NVE Rev.2, nëpërmjet disa treguesve ekonomik, që mundëson krahasueshmërinë e të dhënavëve në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standartet Evropiane për statistikat tremujore. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacione më të plota statistikore në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitetet e industrisë (B, C, D dhe E), në të gjithë territorin e vendit. Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt.

Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

1.2. Fusha e mbulimit

Bazuar në aktivitetin kryesor, në këtë anketë tremujore janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

1. Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
2. Energji elektrike (35)
3. Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39).

1.3. Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) të të dhënave

Mbledhja e të dhënave është kryer kryesisht përmes :

- metodës së intervistimit të drejtpërdrejt nga anketuesit e ASK-së.
- metodës së dërgimit të pyetësorit në mënyrë elektronike.
- metodës së lënies së pyetësorit për plotësim tek biznesi.

Anketa në teren del 20 ditë pas përfundimit të tremujorit dhe afati për grumbullimin e të dhënave nga tereni është 40 ditë pas daljes në teren.

1.4. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës

Për krijimin (përcaktimin) e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga regjistri statistikor i bizneseve. Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë viteve referuese për vitet paraprake janë konsideruar aktive. Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të kriterit ku janë përfshirë të gjitha ndërmarrjet që përfaqësojnë 80% të qarkullimit për aktivitetin përkatës të NVE Rev2. Numri i ndërmarrjeve të përfshira në anketë është 720 ndërmarrje që merren me prodhimtari industriale.

2. Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

2.1. Definicione dhe përkufizime

Ndërmarrja është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Ndërmarrje aktive - konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues.

Vlera e vëllimit nga prodhimi industrial - paraqet vëllimin e realizuar nga prodhimi duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variable të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres.

Indeksi i vlerës së vëllimit nga prodhimi - Objktivi i indeksit të vlerës së vëllimit është të paraqet vëllimin e prodhimit industrial.

Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë që punojnë në ndërmarrje (përjashtuar pjesëtarët e familjes që punojnë pa pagesë).

Indeksi i Numrit të punësuarve - Indeksi i punësimit paraqet securinë e punësimit në ndërmarrjet e anketuara.

2.2. Treguesit themelorë

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht $2017 = 100$.

Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabilë të dhënë ose tërësi variablash.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Matë ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Matë ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsyet: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlerësimë të koeficienteve të përdorur, etj.

3. Industria

3.1. Struktura e vëllimit të prodhimit nga aktivitetet Industriale (B,C, D dhe E)

Tremujori i dytë 2019 - Tremujorin e dytë 2018

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM2 – 2018), rritje kemi në sektorin e industrisë përpunuese (C) me 7.41 %, rritje kishte edhe tek furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) me 1.86%, kurse ulje kishte industrinë nxjerrëse (B) me (3.07) % si dhe furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) me (6.25)%.

Tremujori i dytë 2019 - Tremujorin e parë 2019

Në tremujorin e dytë të vitit 2019 krahasuar me tremujorin e parë 2019,furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit te mbeturinave (E), kishte rritje 10.37% ,rritje kishte edhe në sektorin e industrisë nxjerrëse (B) me 6.08% , kurse ulje kishte në sektorin e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër te kondicionuar (D) për (23.14%) dhe tek sektori i industrisë përpunuese(C) me (4.63%).

3.2. Numri i të punësuarve nga aktivitetet Industriale (B, C, D dhe E)

Tremujori i dytë 2019 - Tremujorin e dytë 2018

Në raport me tremujorin e dytë të vitit 2018, në tremujorin e dytë të vitit 2019 kishte rritje te numrit të të punësuarve në sektorin e industrisë nxjerrëse (B) me 9.31 %, rritje kishte edhe ne sektorin e furnizimit me rryme ,gaz, avull dhe ajër te kondicionuar (D) me 4.42%, rritje kishte edhe ne sektorin e industrisë përpunuese (C) me 0.07%, ndërsa ulje kishte ne sektorin e furnizimit me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit te mbeturinave (E) me (0.76%).

Tremujori i dytë 2019 - Tremujorin e parë 2019

Sa i përket numrit të të punësuarve në tremujorin e dytë të vitit 2019 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019 industria nxjerrëse (B) kishte rritje të numrit të të punësuarve prej 15.40%, rritje kishte edhe tek furnizimi me ujë ,veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit te mbeturinave (E) për 3.27%, si dhe në sektorin e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër te kondicionuar (D) me 0.61%, dhe në sektorin e industrisë përpunuese (C)me 0.45%.


4. Indeksi i vëllimit të prodhimit dhe numrit të të punësuarve nga aktivitetet Industriale (B, C, D dhe E)

4.1. Indeksi i vëllimit të prodhimit

Tab 1. Indeksi i vëllimit të prodhimit (2017=100)

Aktiviteti	TM1 2017	TM2 2017	TM3 2017	TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	72.1	96.6	110.8	120.5	64.0	106.2	116.9	102.1	81.4	102.9
Industria përpunuese	71.5	101.1	111.3	116.1	73.9	101.2	107.8	111.9	75.6	108.7
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	115.2	99.1	88.8	96.9	114.4	89.9	104.1	107.6	115.0	84.3
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	89.5	100.2	103.5	106.9	134.1	105.2	96.3	96.8	139.9	107.2


Figura 1. Indeksi i vëllimit të prodhimit sipas aktiviteteve B,C, D dhe E (2017=100)



Tab 1a. Ndryshimi i Indeksit të vëllimit të prodhimit industrial nëpër periudha tremujore me tremujorin paraprak

Aktiviteti	TM2 2017	TM3 2017	TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019
	TM1 2017	TM2 2017	TM3 2017	TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	33.92	14.68	8.80	-46.92	65.96	10.09	-12.66	-20.31	6.08
Industria përpunuese	41.39	10.15	4.25	-36.32	36.90	6.49	3.83	-32.40	-4.63
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-13.94	-10.43	9.15	18.05	-21.42	15.78	3.38	6.82	-23.14
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	11.97	3.26	3.31	25.46	-21.55	-8.50	0.57	44.50	10.37

Figura 2. Ndryshimi i Indeksit të vëllimit të prodhimit sipas aktiviteteve B,C, D dhe E (2017=100)



Tab 1b. Ndryshimi i indeksit vëllimit të prodhimit industrial nëpër periudha tremujore me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak


Aktiviteti	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	%
	TM1 2017	TM2 2017	TM3 2017	TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	-11.30	9.93	5.53	-15.29	27.18	-3.07	
Industria përpunuese	3.40	0.11	-3.22	-3.61	2.32	7.41	
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-0.67	-9.30	17.23	11.04	0.48	-6.25	
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	49.87	5.00	-6.96	-9.42	4.32	1.86	

4.2. Indeksi i numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial

Tab 2. Indeksi i numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial (2017=100)

Aktiviteti	TM1 2017	TM2 2017	TM3 2017	TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	99.6	97.9	103.3	99.2	93.5	101.0	117.9	110.5	95.7	110.4
Industria përpunuese	93.9	101.2	103.7	101.2	101.2	104.1	104.4	101.7	103.7	104.2
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	100.9	100.1	99.8	99.2	98.6	97.8	96.2	96.5	101.5	102.1
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	91.7	98.7	103.1	106.6	102.8	109.1	114.3	115.8	104.8	108.3


Figura 3. Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve B, C, D dhe E (2017=100)



Tab 2a. Ndryshimi i indeksit të numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial nëpër periudha tremujore me tremujorin paraprak

Aktiviteti	% %								
	TM2 2017 TM1 2017	TM3 2017 TM2 2017	TM4 2017 TM3 2017	TM1 2018 TM4 2017	TM2 2018 TM1 2018	TM3 2018 TM2 2018	TM4 2018 TM3 2018	TM1 2019 TM4 2018	TM2 2019 TM1 2019
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	-1.74	5.49	-3.94	-5.75	8.01	16.77	-6.31	-13.43	15.40
Industria përpunuese	7.71	2.51	-2.48	0.03	2.90	0.30	-2.64	2.01	0.45
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-0.82	-0.31	-0.57	-0.66	-0.76	-1.62	0.32	5.16	0.61
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	7.66	4.48	3.37	-3.52	6.11	4.75	1.37	-9.50	3.27

Figura 4. Ndryshimi i numrit të të punësuarve sipas aktiviteteve B, C, D dhe E (2017=100)



Tab 2b. Ndryshimi i indeksit të numrit të të punësuarve nga aktiviteti industrial nëpër periudha tremujore me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak

Aktiviteti	% TM1 2018 TM2 2018 TM3 2018 TM4 2018 TM1 2019 TM2 2019					
	TM1 2017	TM2 2017	TM3 2017	TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	-6.16	3.16	14.20	11.38	2.31	9.31
Industria përpunuese	7.72	2.90	0.68	0.52	2.50	0.07
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-2.34	-2.28	-3.56	-2.69	3.00	4.42
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	12.18	10.56	10.85	8.71	1.97	-0.76

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa fazë historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencionin ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministritë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencionin financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrta, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukture organizative: **Departamentet prodhuese;** Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit veprojn edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 155 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencionin ka ketë strukture kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekondimimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësítë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyra të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekt i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistre do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbyt nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa:** AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>